



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 18/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, në seancën e mbajtur më datë 20.10.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i Degës së LDK-së në Prishtinë, ka parashtuar ankesë me të cilën pretendon se përfaqësuesit e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kanë bërë shkelje ligjore .

FAKTET

Më 19 Tetor 2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Kryetari i Shtabit Zgjedhor të Degës së LDK-së në Prishtinë, duke pretenduar se përfaqësuesit e subjektit politik të PDK-së, kanë bërë shkelje ligjore, në *Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike*. Në qytetin e Prishtinës Subjekti Politik PDK, kanë vendosur billbordet si dhe kanë bërë transmetimin e spotit në operatorët televiziv si KTV dhe RTK të kandidatit për kryetar të komunës së Prishtinës, Z. Astrit Salihu, para fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore, të datës 15 Tetor 2009. Ankuesi ka bashkangjitur fotografimin që duken të jenë billbordet e fushatës së PDK-së.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072) .

Parashtruesi i ankesës pretendon se përfaqësuesit e PDK-së, kanë shkelur Rregullën e zgjedhjeve në *Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike* sepse kanë vendosur billbordet në qytetin e Vitisë para fillimit të fushatës së zgjedhjeve, datë 15 Tetor 2009.

LZP me dispozitën e nenit 44, përcaktohen aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në mënyrat e specifikuar me atë dispozitë ligjore.

LZP me dispozitën e nenit 33 dhe Rregullorja e Zgjedhjeve Nr 11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, me dispozitën e nenit 4, u ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatëve të tyre, të caktuara me këto dispozita ligjore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse veprimet e pretenduara nuk janë bërë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, vlerësohet në pajtim me dispozitat e cituara ligjore se nuk kemi të bëjmë me veprime të ndaluara, për çka edhe vlerësohet se ankesa është e pabazuar.

Për më shumë, në Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, Neni 4.2 përcakton se KZAP-i mund të refuzojë ankesat të cilat nuk i plotësojnë kushtet që janë të parapara në nenin 3 të këtyre Rregullave dhe Procedurave. KZAP-i mundet në kuadër të diskrecionit të vet të kërkoj më tepër informacion nga pala ankuese, kur KZAP-it konsideron se, ky informacion është dashur t'i bashkëngjitet parashtrësës që në fillim, prandaj e hedhë poshtë parashtrësën sepse si e tillë nuk ka siguruar informacionin e kërkuar.

Për më shumë, bazuar në Nenin 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, përveç nëse nuk është saktësuar ndonjë afat tjetër, ankesa duhet të dorëzohet brenda tri ditëve pas ndodhjes së shkeljes së pretenduar apo brenda tri ditëve pasi që për shkeljen e pretenduar është njoftuar parashtruesi i ankesës ose nga dita kur ai është dashur të dijë për të. Meqenëse ankesa nuk specifikon se kur ka ndodhur shkelja e supozuar, KZAP-i gjykon se shkelja duhet të ketë ndodhur 3 ditë para se ankuesi të jetë i vetëdijshëm për shkeljen e pretenduar, kështu që është e papranueshme.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësë në Prishtinë

A nr. 18/2009 më datën 20.10.2009.

Kryesuesi i Panelit
Osman Tmava